



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:109025  
Datë: 24.03.2024  
Numri i dokumentit: 05494735

C.nr.1760/2022

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** gjyqtare Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoresh profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.V. me numër personal ..... nga fshati .... komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.M.S.Xh. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit dhe përparimit në karrierë, vlera e kontestit 1,965.18 euro, jashtë seancës, më datë **22.03.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** në tërësi e pa bazuar, kërkesëpadsisë së paditësit N.V. nga fshati .... komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, me të cilën ka kërkuar që *“të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 01.05.2017 deri më datë 12.03.2019 apo për 21 muaj (për çdo muaj shumën prej 47.88 euro, në shkallë prej 19 % të pagës bazë-457.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit në shumën prej 1,005.48 euro, si dhe për çdo muaj shumën prej 45.70 euro, në emër të përparimit në karrierë në shumën prej 959.70 euro), t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej **1,965.18 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 27.05.2022 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përparimit të detyrueshëm”*.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi N.V. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. M.S.Xh. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit dhe përparimit në karrierë, vlera e kontestit 1,965.18 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës pranë SHFMU “Ekrem Rexha” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Bazuar në kontratëne punës, Ligjin e punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, sipas nenit 7 të

saj, paditësit i takojnë benefitet e specifikuar në këtë kontratë dhe atë duke specifikuar qartë për secilin kualifikim që ka i punësuar sipas nivelit profesional të tij dhe licencimit, konkretisht paditësi N.V. me kualifikim-licencë në karrierë të marrë me datë 20.05.2014, sipas ligjit i takon një rritje nga paga bazë prej 19% si dhe 10% për ngritje në karrierë me vendimin 10/1035 nr.prot.1035 i datës 30.10.2019. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të detyrohet e paditura që paditësit në vendin e punës administrator dhe me kualifikim Shkolla e Lartë Pedagogjike, t'ia paguaj diferencën prej 19% në muaj si dhe 10% për ngritje në karrierë nga paga bazë e tij, prej kur kanë ekzistuar kushtet ligjore sipas KKA-së, me kamat ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurën i ka kërkuar.

Duke vepruar sipas aktvendimin të kësaj gjykate C.nr.1760/22 të datë 20.07.2022, paditësi përmes të autorizuarës së tij me datë 01.08.2022, ka bërë precizimin e kërkesëpadiës duke kërkuar kompensimin sipas KKA-së të datës 18.04.2017, neni 7 pika 1.2, që i takon një rritje nga paga bazë prej 19% si dhe në bazë të nenit 7 pika 1.5 caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10% me vendimin 10/1035 nr.prot.1035 datë 30.10.2019, dhe atë nga data 01.05.2017 deri me datë 12.03.2019, apo për 21 muaj t'ia paguaj diferencën në pagë prej 1,005.48 euro në emër të kualifikimit dhe licencimit në karrierë dhe 959.70 euro në emër të përparimit në karrierë, në shumën e përgjithshme prej 1,965.18 euro, të gjitha këto me kamat ligjore 8%.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësja nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKA-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKA-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditëses. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi N.V. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHFMU "Ekrem Rexha" në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia

e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit dhe përparimit në karrierë, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit dhe përparimit në karrierë është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër të protokollit 230/10 të datës 01.09.2018, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura mësimdhënëse, kualifikimi i paditësit është kualifikim i lartë shkollor, respektivisht i njëjti ka të përfunduar akademinë pedagogjike, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 399, e datës 30.06.1978 e lëshuar nga Akademia Pedagogjike “Dimitrije Tucoviq” në Prizren, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin arsimtar i mësimi klasor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 399.75 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit SHLP, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 38.95 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”, 5) Përparimet në karrierë, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje pagë 10%. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 27.05.2022, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit dhe përparimit në karrierë. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar në tërësi kërkesa, konkretisht nga data 01.05.2017 deri me datë 12.03.2019. Sipas llogaritjes së gjykatës kërkesa

e tillë është parashkruar në tërësinë e saj për 21 muaj apo në shumën e përgjithshme për të dy kërkesat në lartësi prej 1,965.18 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata refuzoi në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në 399 par. 1 të LPK-së, pasi që kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 450, 452 dhe 463 të LPK-së. Pra, përkundër faktit se pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet procedurale, kërkesëpadia e saj ishte e pabazuar dhe kështu ka humbur kontestin në këtë procedurë gjyqësore. Në anën tjetër, përkundër faktit se e paditura ka fituar kontestin, e njëjta nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 të LPK-së lidhur me nenin 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**  
**C.nr.1760/2022, më datë 22.03.2024**

**Gjyqtare**  
**Njomëza Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.